



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1578 / Prot.
2

Tiranë, 6.5-2020

Lënda: Përcillet Vendimi nr.56 datë 06.05.2020 i Rektorit të UT

Drejtuar: **Znj.Majlinda Keta**

Bashkëngjitur ju përcjellim Vendimin nr.56, datë 06.05.2020 të Rektorit të UT *“Për zgjidhjen e menjëhershme, të justifikuar, të kontratës të punës të znj.Majlinda Keta, me Universitetin e Tiranës”*.

REKTORI
PROF.DR.ILYNYR KONI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1578 Prot.

Tiranë, 6.5 2020

V E N D I M

Nr. 56, datë 06.05.2020

PËR ZGJIDHJEN E MENJËHERSHME, TË JUSTIFIKUAR TË KONTRATËS TË PUNËS TË ZNJ.MAJLINDA KETA, ME UNIVERSITETIN E TIRANËS

Sot, në datën 06.05.2020,

I. Për arsye të shkeljeve flagrante të vendimeve, urdhëra, urdhëresave dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, gjatë periudhës të Pandemisë, të shkaktuar nga Covid 19, konkretisht:

- Shkelje flagrante e Aktit Normativ nr.3, datë 15.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, neni 3, pika 2,5,8, neni 6, pika 1, 2, 3.
- Shkelje flagrante e Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr.216, datë 01.04.2020 “Për një ndryshim në urdhrin nr.190, datë 19.03.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit covid-2019”, pika 1.
- Shkelje flagrante e Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr.222, datë 01.04.2020 “Për një ndryshim në urdhrin nr.132, datë 8.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, pika 1,2;
- Shkelje flagrante e Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr.223, datë 01.04.2020 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.156, datë 10.3.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”, pika 1,2;
- Shkelje flagrante e Vendimit nr.18/2020 të Kuvendit të RSH “Për dhënien e pëlqimit për zgjatjen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 1;
- Shkelje flagrante e Vendim nr.243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, pika 1,2, 6, 6/1, gërma a,d,e;
- Shkelje flagrante e Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë nr. 257, datë 10.4.2020 “Për detajimin e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike”, pika 1, 2 (shiko listën e aktiviteteve sipas nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike, rev.2, mbylljen 8542 arsimit i lartë (përgjashtuar mësimdhënia online) ;

II. Për arsye të :

- Shkeljes flagrante të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatit Akademik në Universitetin e Tiranës”, të miratuar me Vendimin nr.5 datë 10.02.2020 të Senatit Akademik të UT, neni 5, pika 3 , duke përgatitur, firmosur dhe dërguar me email, edhe në formë shkresore dokumenta, të cilat janë në shkelje flagrante të rregullores së sipërcituar,
- Moszbatimi i shkresës nr.1553 datë 30.04.2020 të Rektorit të UT “Për ndërprerjen e menjëhershme të veprimeve të paligjshme, me pasoja për Universitetin e Tiranës”.

III. Për arsye të mosrealizimit të Urdhërave dhe porosive të Rektorit të Universitetit të Tiranës, në mënyrë të përsëritur, pavarësisht shpjegimeve dhe arsytetimeve ligjore, të argumentuara ligjërisht, duke mos realizuar në këtë mënyrë detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat që keni patur, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve të Universitetit të Tiranës (KIZ), të zgjedhur me Vendimin nr.8 datë 21.03.2016 të Senatit Akademik të UT, në zbatim të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në RSH”, me nr.2459/4 prot, datë 15.03.2016 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke shkaktuar në këtë mënyrë pasoja të rënda për Universitetin e Tiranës, konkretisht:

- Moszbatimi i Urdhërit të Brendshëm nr.3 datë 04.03.2019 të Rektorit të UT “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës për zhvillimin e zgjedhjeve për disa autoritete dhe organe drejtuese në Universitetin e Tiranës”, përcjellë në KIZ me shkresën nr.1048/1 datë 04.03.2019 të Rektorit të UT;
- Moszbatimi i shkresës nr.1136/1 datë 11.03.2019 të Rektorit të UT “Mbi tuajën nr.6 datë 07.03.2019”, në lidhje me detyrat dhe kompetencat ligjore të anëtarit të KIZ-it;
- Moszbatimi i shkresës nr.2955/6 datë 01.07.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Kthim përgjigje”;
- Moszbatimi i shkresës nr.1136/10 datë 04.07.2019 të Rektorit të UT “Për zbatimin e detyrimeve dhe kompetencave ligjore të KIZ”;
- Moszbatimi i shkresës nr.1136/12 datë 25.07.2019 të Rektorit të UT “Mbi shkresën nr.12 datë 15.07.2019 të KIZ të UT”;
- Moszbatimi i Urdhërit të Brendshëm nr.15 datë 04.07.2019 të Rektorit të UT “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës për zhvillimin e zgjedhjeve për komisionet e përhershme në nivel njësie kryesore për dhënin e gradës shkencore “Doktor” në fakultetet e Universitetit të Tiranës”;
- Moszbatimi i Urdhërit të Brendshëm nr.16 datë 02.09.2019 të Rektorit të UT “Për disa ndryshime në Urdhërin e Brendshëm nr.15 datë 04.07.2019 të Rektorit të UT “Për fillimin e procesit zgjedhor dhe përcaktimin e datës për zhvillimin e zgjedhjeve për komisionet e përhershme në nivel njësie kryesore për dhënin e gradës shkencore “Doktor” në fakultetet e Universitetit të Tiranës”, përcjellë në KIZ me shkresën nr.3123/7 datë 03.09.2019 të Rektorit të UT;

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 12, në nenin 154, pika 1, 2 të ligjit nr.7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar; në nenin 39, pika 5 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; në nenin 34, pika 1/b të Statutit të UT; në nenin 30, pika 3 të Rregullores së UT,

V E N D O S A:

1. **Znj.Majlinda Keta**, deri tani personel akademik në Departamentin e Filozofisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, të Universitetit të Tiranës, t’i zgjidhet në mënyrë të menjëhershme, të justifikuar, kontrata e punës me Universitetin e Tiranës.
2. Ky Vendim i përcillet për njoftim dhe për zbatim Fakultetit të Shkencave Sociale të UT.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
PROF.DR.MYNYR KONI

